


## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### NAVIG

Me ane te ketij dokumenti sot me daten 16.09.2022  
Z.**Neritan Dakoli**, i lindur ne Durres, me 01/08/1974,  
banues ne Durres, lagjen nr.9, Rruga Aleksander  
Goga, pallati 530/1, mbajtes i kartes identitetit me  
nr.personal H40801091T, otak i vetem vendos sa me  
poshte vijon :

1. Te themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar te emertuar **NAVIG**.
2. Shoqeria NAVIG eshte nje person juridik i te drejtes shqiptare qe operon si e tille nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Biznesit.  
Aktiviteti i saj do te rregullohet konform dispozitave te ketij Akti, te Statutit bashkangjitur dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi.
3. Kohezgjatja e veprimtarise vendoset te jete e pacaktuar, por mund te ndryshohet ne unanimitet nga ortaket.
4. Shoqeria ka per objekt te aktivitetit te saj :  
Menaxhimin e shërbimeve dhe të strukturave portuale të të gjithë tipave, aktivitetet e tregtisë detare dhe ato që lidhen me to.  
Ushtrimin e gjithë veprimtarive të shërbimeve detare dhe portuale të anijeve e mjeteve off-shore, në portet dhe ujërat kombëtare dhe ndërkombëtare, të tilla pa kufizim, si rimorkimi i mjeteve lundruese, shpëtimi i jetës dhe anijeve në det, shërbimet e sigurisë dhe mbrojtjes ndaj zjarrit, shërbimet e lidhjeve-zgjidhjeve të anijeve, atë të pilotimit të tyre, aktivitetet e agjencisë detare dhe spedicionere, doganore, tërheqjen e mbeturinave të ngurta, vajore dhe të lëngshme nga anijet, shërbimet kundër ndotjes së porteve dhe të hapësirave detare, shërbimet e sigurisë (Safety) në porte dhe radë.  
Ndërmarrjen dhe zbatimin e kontratave publike dhe private për ushtrimin e shërbimeve në aktivitetet që kryhen në ujërat detare kombëtare dhe ndërkombëtare.  
Transportin detar të pasagjerëve dhe mallrave të të gjithë llojeve dhe strukturave me mjetet e veta apo të çarteruara.



Punime të të gjithë kategorive të veprimtarisë detare e ujore, inspektime nën-ujore dhe kryerjen e matjeve batimetrike të reliefëve nën-ujore detare. Shërbimet për tërheqjen dhe grumbullimin e mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme të mjeteve lundruese dhe anijeve, në porte, det të hapur apo në spirancë në rada.

Shërbimin e mirëmbajtjes të aseteve dhe objekteve portuale, në marina dhe të sipërfaqeve ujore të tyre. Shërbimin e dhënies të asistencës anijeve në det, platformave lundruese dhe kërkimore, për nxjerrjen e hidrokarbureve, pontoneve, qofshin ato fikse apo të lëvizshme.

Shërbime kantieri për mirëmbajtjen e mjeteve detare, të ndërtimit të anijeve dhe gjithë tipave të mjeteve lundruese.

Shoqëria mund të kryejë të gjitha llojet e veprimtarive tregtare, të import-eksportit, në pronat e luajtshme dhe të paluajtshme, që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimeve ekonomike të saja, ajo gjithashtu mund të ketë pjesëmarrje me investime në shoqëri e biznese të tjera të të tretëve, si dhe të sigurojë fonde nga palët e treta për ecurinë e qëllimeve të përbashkëta të shoqërisë.

Të realizojë veprimtari dhe menaxhimi të instalimeve, impianteve dhe teknologjive të ndryshme në fushën industriale. Prodhime impiantesh për aktivitetet petroliferike, administrimin, menaxhimin e shpërndarjen e prodhimeve të naftës e gazit.

Shoqëria me vendim të bordit administrativ, në qëllim të realizimit të objektivave të saja, mund të kryejë marrëveshje tregtare dhe bashkëpunimi me kompani e ndërmarrje të tjera të ndryshme për të zgjeruar kur e sheh të arsyeshme, veprimtarinë e saj ekonomike. Kompania mund të bëjë marrëveshje për marrje kredie, ose blerjen e pronave, për ushtrimin efektiv të biznesit të saj.

Të hulumtojë dhe industrializojë teknologji të reja, sisteme bashkëkohore dhe pajisje që lidhen me veprimtarinë detare, portale, të ndërtimit të anijeve të të gjithë llojeve e tipave si civile ashtu dhe ushtarake. Të ushtrojë aktivitetin e rekomandime të tregtisë detare dhe të angazhohet drejt për drejt me veprimet e nevojshme operative dhe administrative në shërbim të pronarëve të anijeve dhe për llogari të tyre, si vendas ashtu dhe të huaj. Kurse të formimit profesional për përgatitjen e stafeve të sigurisë portuale dhe të anijeve, kurse për pilot detar dhe ormexhatorë dhe

- kurse për aftësimin në drejtimin e mjeteve lundruese motorike dhe velierave deri në 24 metra gjatësi.
5. Selia e shoqërisë vendoset te jete ne Durres, Lagja nr.1, Rruga Taulantia, Zona kadastrale 8512, Nr.pasurie 24/90-N8,Pallat 12-katesh,kati pare.
  6. Kapitali shoqëror fillestar eshte ne vleren 100.000 leke(Njeqindmije),i perbere nga 1 kuote dhe 100% ne zoterim te Ortakut te Vetem te shoqërisë **Z.Neritan Dakoli**.
  7. Administrimi dhe perfaqesimi i shoqërisë i besohen nje Administratori te Vetem, qe mund edhe mos te jete ortak. Administratori i Vetem emerohet per maksimumi 5 vjet,perveç rasteve kur jep doreheqjen ose shkarkohet nga Asamblea e pergjithshme. Administrator i Vetem i shoqërisë emerohet z. Neritan Dakoli, lindur me date 01.08.1974,ne Durres, i identifikuar me karte identiteti, me nr.personal H40801091T, me banim ne lagjen nr.9, Rruga Aleksander Goga,pallati 530/1,Durres te cilit i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqesimit te shoqërisë. Administratori i Vetem ka te gjithë kompetencat per realizimin e objektit te shoqërisë, me perjashtim te kompetencave te dhena nga ky Akt dhe nga Statuti ekskluzivisht Asamblese se pergjithshme.
  8. Viti ekonomik ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Viti i pare ushtrimor mbyllet me date 31 Dhjetor 2022.
  9. Ne perfundim te vitit ushtrimor , pas aprovimit te bilancit, Asamblea mund te vendose shperndarjen e fitimit neto. Ky fitim mund te transferohet lirisht jashte Shqiperise konform legjislacionit ne fuqi. Per humbjet pergjigjet ekskluzivisht shoqëria me kapitalin e saj.
  10. Ortaku dhe administratori jane te detyruar te ruajne konfidencialitetin mbi dokumentacionin, te dhenat, njohurite dhe eksperiencat e fituara gjate aktivitetit te shoqërisë, si dhe te marre te gjitha masat e nevojshme te sigurise per te evituar perhapjen, qofte edhe pjesore, te tyre. Ata jane pergjegjes per pasoja te mundshme negative nga shkelja nga ana e tyre e sa me siper thene.
  - 11.Persa nuk specifikohe shprehimisht ne kete akt, vlejne normat e Statutit bashkangjitur.

## **ORTAKU I VETEM**

**NERITAN DAKOLI**

**NERITAN DAKOLI**

